

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca-Dula, kryetare e kolegjit, Gëzim Llulluni dhe Albet Zogaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.M. nga Peja, të cilën e përfaqëson av. B.L. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Pejës, Drejtoria për Arsim - Pejë, të cilën e përfaqëson i autorizuari av.B.B., për shkak të pagesës së të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.791/13, i datës 19.02.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.07.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditëses N.M. nga Peja, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me shenjë C.nr.791/13, i datës 19.02.2014, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.791/14, të datës 19.02.2014, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.M. nga Peja, kundër të paditurës Komuna e Pejës, Drejtoria për Arsim -Pejë me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura t'ia paguaj paditësit borxhin në shumë prej 1178,24 €, me kamatë ligjore në lartësi prej 3.5% nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 104 €, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore gjykata ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësit në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të autorizuarit të paditëses dhe të ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë C.nr. 791/13 të dt.19.02.2014 dhe të aprovojë kërkesëpadinë si të bazuar ose aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lënda të kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

E paditura nuk ka dhënë përgjigje në ankesën e paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e paditësit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 06.08.2013, në Gjykatën Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, ka paraqitur padi kundër të paditurës, Komuna e Pejës - Drejtoria për Arsim - Pejë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj borxhin prej 1178,24 euro, për dy paga mesatare për përcjellje në pension, me kamatë ligjore dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e të gjitha në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm me kërcenim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse, në seancë të shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.791/13, i datës 19.02.2014, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se kërkesëpapia e paditësit N.M. e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Pejës, Drejtoria për Arsim - Pejë, nuk ishte e bazuar në dispozita ligjore, pasi që Kontrata Kolektive e nënshkruar nga Oda e Ekonomike e Kosovës, në Prishtinë, Bashkësia e Sindikatave të Pavarura të Kosovës në Prishtinë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, nuk është e zbatueshme dhe nuk prodhon efekte juridike. Është vlerësuar nga Gjykata e Shkallë së parë se kontrata kolektive në bazë të së cilës paditësi kërkon kompensimin e pagave nuk ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi ka shkuar në pension, faktin se kontrata ka hyrë në fuqi me 01.01.2005, me një kohëzgjatje prej tri vite, pra deri me datën 01.01.2008 kur ka përfunduar vlefshmëria juridike e saj. Rregullorja e UNMIK-UT 2001/35, Mbi Pensionet në Kosovë, Rregullorja e UNMIKU-ut 2005/20 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë dhe Ligji Nr. 03/L-084 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35, për Fondin Pensional të Kosovës, në asnjë dispozitë nuk përcakton pagesën e pagave përcjellëse për shkuarjen në pension, përkundrazi neni 35 i kësaj Rregulloreje shprehimisht cekë se kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g),(j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet për shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat janë pretenduar me ankesë në lidhje me kundërthëniet e dispozitivit me arsyet e aktgjykimit dhe me provat e administruara, pasi që sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit është koherent dhe i qartë, ndërsa arsyet e aktgjykimit janë në përputhje të plotë më mënyrën e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur së gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë duke u mbështetur në provat e administruara

të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Gjykata e Apelit e ka pranuar në tërësi vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë pasi që nga shkresat e lëndës rezulton së nuk ka qenë rrethanë kontestuese fakti së paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura deri në arritjen e moshës së pensionit, përkatësisht deri me datën 12.04.2011. Kjo rrethanë është provuar edhe nga vendimi i të paditurës i datës 16.05.2011, nën numër 205124, për përfundimin e marrëdhënies së punës sipas fuqisë së ligjit.

Kontrata Kolektive ka filluar të zbatohet nga data 01.01.2005, me kohëzgjatje të zbatimit për tri vite përkatësisht deri me datën 01.01.2008, kur të njëjtës i ka skaduar afati i zbatimit përkatësisht i ka pushuar efekti juridik. Edhe sipas dispozitës së nenit 90 paragrafi 4 i Ligjit të Punës, përcaktohet së: “ *Marrëveshja kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet*”.

Me skadimin e afatit të Kontratës Kolektive e njëjta nuk mund të aplikohet për rastet tjera pas datës 01.01.2008, e as për rastin e paditësit meqë padia është paraqitur në gjykatë me datën 06.08.2013, ndërsa paditësi është pensionuar me datën 12.04.2011, pasi që ka pushuar së zbatuari Kontrata e Përgjithshme Kolektive.

Nga arsyet e paraqitura me lart, e në pajtim me nenin 194, 195 par 1, pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2178/14, me datë 17.07.2017

Kryetare e kolegjit-gjyqtare:
Nora Bllaca – Dula